



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.03.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Genc Pollo – kryetar i Komisionit

Rend i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 07.02.2018
2. Miratimi i procesverbalit të datës 16.02.201
3. Miratimi i procesverbalit të datës 21.02.2018
4. Miratimi i kalendarit të Komisionit të Integritimit European për periudhën 19 mars – 6 prill 2018
5. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Genc Pollo, Bledar Çuçi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi Aldo Bumçi, Vangjel Dule, Jorida Tabaku, , Viktor Tushaj, Eglantina Gjermani, Rudina Hajdari, Klajda Gjoshaj

Mungojne

Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Taulant Balla, Grida Shqina (Duma) , Monika Kryemadhi.

HAPET MBLEDHJA

Genc Pollo – Mirëmëngjesi, zonja dhe zotërinj deputete!

Duke ju uruar një javë të mbarë, fillojmë mbledhjen!

Sipas axhendës që ju është propozuar, parashikohet miratimi i katër procesverbaleve dhe futja në kalendarin e punës së komisionit tonë të projektligjit për statistikën zyrtare, të depozituar rishtas në Kuvend.

Para se të vijmë te çështjet konkrete të rendit të ditës, unë do t'ju prezantoj një shqetësim timin, por të ngritur edhe nga kolegë të tjerë. Ne të gjithë e dimë dhe biem dakord se Kuvendi, dhe në emër të tij, komisioni ynë duhet të jetë proaktiv në kërkimin e llogarisë ndaj qeverisë për hapat e hedhur për integrimin europian, sidomos në këta 6 muaj. Në këtë kuadër, në dhjetor kemi rënë dakord të ftojme tri anëtarë të qeverisë, të cilët përgjigjen për pesë prioritetet e Bashkimit Europian. Zëvendëskryeministria, Mesi, dhe ministri i Brendshëm, Xhafaj, deri tani nuk kanë ardhur ende. Me gjithë kërkesën e vazhdueshme, sekretarët thonë se nuk kanë caktuar një datë. E kam të vështirë të kuptoj arsyen e kësaj mungese, të mosparaqitjes, nëse është mosdëshira, janë problemet që kanë dalë, raporti i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, që raporton se, të paktën, 30% e emërimeve janë të paligjshme, apo problemet e tjera të luftës kundër kriminalitetit. Shpresoj të mos jetë kështu, por shqetësimi mbetet.

Gjithashtu, ka një tjetër zhvillim apo thjesht deklaratë nga ministri për Europën, nuk e di nëse mund ta quaj, por meriton vëmendjen tonë, që tha para 5 ditësh se mjafton vetingu për të çelur negociatat, ndërkohë që kushti zyrtar dhe i pandryshueshëm nga një organ i vetëm i Bashkimit Europian janë pesë prioritetet, përmbushja e të cilave është mirë edhe për vendin në radhë të parë. Ju kujtoj se pesë prioritetet përmbajnë administratën publike, luftën kundër korrupsionit dhe luftën kundër kriminalitetit, përfshi edhe kriminalitetin e organizuar dhe narkotikët, gjë që ndoshta do të diskutohet në komisionin tonë ose edhe në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian. Mosparaqitja e dy anëtarëve të qeverisë ishte një shqetësim që unë do të doja ta ndaja mes jush dhe ndoshta mund të sugjeroni si mund ta trajtojë komisioni këtë çështje, si dhe përfshirja dhe respekti që duhet të kemi për veten dhe për institucionin tonë.

Siç ju thashë, në rendin e ditës janë çështjet që shtrova, për të cilat besoj se kemi konsensus për t'i miratuar, përfshirë edhe procesverbalet.

Anëtarët e komisionit duan të marrin fjalën për çështjet e rendit të ditës dhe për shqetësimin që unë shtrova?

Zoti Çuçi, urdhëroni!

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Unë nuk kam asgjë të veçantë, por ne të dy si kryesi e komisionit mund të bëjmë një përpjekje. Jam shumë dakord që duhet t'i ezaurojmë sa më parë dy dëgjesat që kemi vënë në dhjetor në axhendën e komisionit.

Besoj se ka qenë ndoshta axhenda, sidomos e ministrit të Brendshëm, që është edhe më shumë e ngarkuar, që nuk ka gjetur hapësira brenda hapësirave tona, por jam i gatshëm, edhe në rolin e nënkryetarit të nënkomisionit, që bashkërisht të bëjmë një përpjekje t'i mbyllim të dyja dëgjesat brenda këtij muaji ose dyjavëshit të parë të muajit tjetër.

Deri diku i bashkohem qëllimit të mirë që ka komisioni për këto dy dëgjesa, që janë shumë të rëndësishme. Jam shumë dakord me ju që pesë prioritetet në një farë mënyre janë një parakontratë e shtetit shqiptar me Brukselin. Thënë këtë, dua të sqaroj diçka më tepër për deklaratën e ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme, që nuk përmbledh të gjithë punën e bërë nga qeveria shqiptare këto vitet e fundit, por është thjesht një deklaratë në një moment të caktuar, kur, pa diskutim, i gjithë fokusi, edhe i Brukselit, mbetet te zbatimi i vetingut. Pa diskutim që edhe ministri i Punëve të Jashtme e ka shumë të qartë, e ka thënë vazhdimisht, se qeveria shqiptare, shteti shqiptar në përgjithësi, duhet të ecë me ritmin e zbatimit të pesë prioritetëve të vendosura nga Brukseli. E thashë thjesht për të sqaruar ndonjë keqkuptim që mund të ketë ardhur nga kjo deklaratë. Ne mbetemi të hapur, sidomos për pikën e parë, që të bëjmë një përpjekje të fundit, edhe ne të dy bashkë, për t'i sjellë sa më shpejtë në këto dy dëgjesa.

Genc Pollo – Patjetër.

Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zonja Gjoshja. Më pas e ka fjalën zonja Tabaku.

Klajda Gjoshja – Unë jam plotësisht dakord, zoti kryetar, për ato që ju thatë, për të pasur si zëvendëkryesministren, edhe zotin Xhafaj, për një nga prioritetet kryesore që ka të bëjë me çështjen e krimit të organizuar, por edhe korrupsionit në këtë vend. Unë do të sugjeroja se përveç këtyre përfaqësuesve të lartë të qeverisë, ne të kishim mundësi në një seancë dëgjimore, para raportit të Komisionit European, të kemi edhe zotin Bushati, për shumë arsye.

E para, sepse këto janë ditët që qeveria shqiptare dorëzon pranë Komisionit European raportimin për pesë prioritetet dhe komisioni do të bëjë pikërisht vlerësimin për raportin që do të dërgojë pala shqiptare. Pra, do të jetë mirë që ky komision të njihet përgjithësisht me raportin

për pesë prioritetet, por edhe më gjerë, sepse raporti që dërgon tashmë qeveria shqiptare nuk ka të bëjë vetëm me këto pesë prioritetet, por ka të bëjë edhe me sektorë të tjerë, edhe me pjesën financiare të Bashkimit European, edhe me fondet e paraadimit IPA dhe është mirë të kemi një seancë më të gjerë për këtë çështje dhe aq më tepër, duke pasur parasysh se janë kryer një sërë takimesh edhe me vendet anëtare apo me përfaqësues të lartë të vendeve anëtare, do të ishte mirë që komisioni të dëgjonte cili është mendimi i vendeve anëtare për çeljen e negociatave për Shqipërinë dhe cila do të jetë atmosfera, pse jo, edhe në qershor, kur Këshilli të mbledhet e të vendosë për negociatat dhe, njëkohësisht, cilat do të jenë hapat që do të marrë Ministria e Jashtme për të lobuar dhe për të prezantuar sukseset, por edhe problematikat që ka vendi apo edhe ndonjë lidhje marrëveshjeje për zbatimin e prioritetëve kyçe deri në qershor, kur do të kemi edhe vendimin për çeljen e negociatave. Mendoj se mund të konsiderohet si një alternativë për të pasur edhe zotin Bushati në komision.

Genc Pollo – Faleminderit!

Unë jam dakord që kalendarin e muajit prill do ta shikojmë në fokusin e zhvillimeve të veçanta të atij muaji.

Për dijeninë tuaj, edhe pse ju mund të jeni të informuar, javën e ardhshme do të mbledhet Këshilli Kombëtar i Integritetit European me praninë e ministrit të Jashtëm, ku do të flasin për këto gjëra dhe është gjithmonë një dilemë e vogël nëse ky prezantim do të bëhet në atë Këshill apo në këtë komision, por këtë do ta zgjidhim rrugës.

Sidoqoftë, fokusi për raportin e prezantuar duhet të jetë. Do ta shikojmë në javët e ardhshme për ta përfshirë siç duhet. Ju kam thënë edhe më herët, në janar ndoshta, se raporti i qeverisë, dërguar Kuvendit, për çfarë ka bërë për integrimin evropian, ka qarkulluar dhe mund të shërbejë si bazë e diskutimit në pritje të raportit tjetër specifik të muajit prill.

Jorida, urdhëroni!

Jorida Tabaku – Pa dashur të përsëris kolegët për kërkesën e komisionit për praninë e dy ministrave, nuk besoj se është çështje axhende, pasi qeveria shqiptare ka detyrë tjetër deri në qershor përveç përmbushjes së detyrimeve që kanë mbetur nga pesë prioritetet. Ne këtu kemi nevojë edhe për një informacion më të detajuar nga secila prej ministrave, nga qeveria, për planin konkret të punës dhe të gjitha detyrimet që është duke plotësuar çdo ministri. Ne këtu u prezantuar nga Ministria e Drejtësisë me një informacion për prioritetet që ndiqte. Patëm një diskutim, besoj konstruktiv.

Ndërkohë, kemi pasur shqetësime, kryesisht nga reporterit i Parlamentit Gjerman, zoti Frai, që lidhen në mënyrë specifike me krimin e organizuar dhe me luftën kundër narkotrafikut.

Besoj se kjo duhet të jetë mbledhja e parë e këtij komisioni dhe detyra e parë dhe e vetme e qeverisë.

Ne këtu diskutojmë, shikojmë rezultatet që na prezantohen. Secila prej palëve këtu ndoshta mund të japë shpesh edhe mendime politike, por është detyrë e qeverisë ta marrë seriozisht këtë proces. Nëse vonohemi 3 muaj e gjysmë për të raportuar si janë përmbushur detyrimet, unë shikoj një mungesë të qartë të vullnetit politik nga njëra anë, por, nga ana tjetër, edhe një dekurajim që ka ndodhur në të gjithë qeverinë, duke e ditur se ky proces është në dorën e tyre, duke e ditur se është një proces merite. Qartësisht duket se qeveria ka hequr dorë dhe është dekurajuar për të realizuar detyrën e parë që duhet të kishte për procesin e integritetit.

Genc Pollo – Faleminderit, Jorida!

Ka kolege apo kolegë të tjerë që duan fjalën për këtë çështje të rëndësishme?

Nëse nuk ka, besoj se jemi të qartë për çfarë mendojmë dhe çfarë synojmë.

Kalojmë në miratimin e çështjeve që janë parashikuar në rendin e ditës.

Procesverbali i katër mbledhjeve miratohet.

Gjithashtu, edhe përfshirja është vendim i Kuvendit dhe i Konferencës së Kryetarëve para projektligjit për statistikën zyrtare.

Para se të ndalemi te caktimi i relatorëve, duhet një sqarim për komisionin për relatorin e projektligjit për trashëgiminë kulturore, sepse zoti Velaj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, ta shpjegoj, që të jemi të qartë. Për arsye të konfliktit të interesit, mendoi të tërhiqej nga funksioni i relatorit të shumicës për këtë projektligj.

Ndërkohë, është diskutuar dhe zoti Çuçi mund ta sqarojë.

Bledar Çuçi – Po, e sqarova edhe zotin Velaj, nuk ka lidhje fare me konfliktin.

Genc Pollo – Mbeten zoti Velaj dhe zonja Duma relatorë të këtij projektligji.

Për projektligjin për statistikën zyrtare mendoj se do të jenë relatorë zonja Tabaku nga opozita, që e ndjek këtë dhe një komision tjetër, dhe nga maxhoranca do të jetë zoti Kamami. Këta të dy do të jenë relatorë të projektligjit që është parashikuar të shqyrtohet më 29 mars në seancë plenare.

Jorida, jemi të sigurt që është datë realiste?

Jorida Tabaku – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Komisioni i Ekonomisë është komision përgjegjës.

Genc Pollo – Do t’u lutem relatorëve të fillojnë nga puna dhe të paraqesin materialet e tyre në kohë, që komisioni ynë për dhënie mendimi të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga rregullorja, duke pasur parasysh datën 29 mars.

Keni gjë tjetër? Nuk ka.

Faleminderit dhe shihemi në mbledhjen e ardhshme!

Kam edhe sqarim. Ndoshta e lexuat, por është më mirë nëse thuhet me zë. Nesër kemi mbledhje për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Francës dhe Komisionit European për programin Interreg V-B Mesdhe (MED), 2014-2020”. Meqë është marrëveshje standarde, nuk e përmenda, por ju besoj se e keni parasysh. Kemi nevojë, relatorë, për marrëveshje të tilla? Do të kemi nga qeveria dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nesër në orën 10:00 kemi mbledhje për marrëveshjen që lexova.

(Diskutime pa mikrofon.)

MBYLLET MBLEDHJA